POSTIM ARKIVOR

# Vendimet e Internimit në Shqipëri (1944–1990)



...rrezikshmëni arratisje për në Jugosllavi.

V 8)Të internohet në Lushnjë Hy[redacted],i biri H[redacted]i dat-lindjes 1913,lindur në qytetin e Gjirokastrës,për arsye se paraqet rrezikshmëni shoqërore.

Internimi ju fillon më 19/3/1965 dhe ju mbaron më datën 19/3/1970 për 5 vjet kohë.

KRYETAR'I KOMISJONIT T'INTERNIM-DËBIMEVE
GJENERAL-KOLONEL
(Beqir Balluku)

| ZV.KRYETAR KOMISJONI | A N T A R | A N T A R | A N T A R |
|---|---|---|---|
| GJENERAL-LEITNANT | MINISTËR DREJ. | PROKUROR PËRGJ. | KRYETAR GJYK.L |
| (Kadri Hazbiu) | (Bilbil Klosi) | (Aranit Çela) | (Shuaip Panariti) |

SEKSIONI

Kampet e Lushnjes

PERIUDHA

1954 - 1954

Vendimet e internimit ishin akte administrative përmes të cilave regjimi komunist dëboi dhe izoloi mijëra individë dhe familje në kampe dhe zona të caktuara internimi. Në vitet e para të regjimit, këto masa merreshin shpesh pa një proces të rregullt gjyqësor, ndërsa pas vitit 1955 mekanizmi u formalizua përmes Komisionit të Internim-Dëbimeve. Internimi u përdor si instrument represioni politik, duke prekur edhe familjarët e personave të arratisur apo të dënuar politikisht. Praktika vijoi deri në vitin 1990; vendimi i fundit i internimit vlerësohet të jetë marrë më 10 shkurt 1990, ndërsa më 8 maj 1990 u shfuqizua ligji për internimet dhe dëbimet.

PERMBAJTJE #1

# Vendime Internimi

Lushnja ishte një nga zonat ku u zbatua gjerësisht politika e internimit. Dokumentet arkivore dëshmojnë vendosjen dhe transferimin e familjeve të internuara, kushtet e jetesës dhe kontrollin administrativ mbi to. Dokumentacioni i Lushnjës, përfshirë vendime internimi, kartela, regjistra dhe dokumente të tjera administrative, bën të mundur rindërtimin e historisë së individëve dhe familjeve të prekura dhe tregon se si vendimi i internimit shndërrohej në një realitet të përditshëm izolimi.

MEDIA #1

# Vendime të Komisionit të Internim-Dëbimeve për masa internimi, lirime nga internimi, konfiskim të pasurisë ndaj personave që zhvillojnë veprimtari armiqësore.

MEDIA FAQE #1



Mod. 7

Emërtimi i institucionit Drejtoria I-rë e Sig. Shtetit

Emërtimi i sektorit Dega Hetuesisë

DOSJE Nr. 16 Viti 1954

TITULLI I DOSJES

Vendime të Komisionit të Internim-Dëbimeve për masa internimi, lirime nga internimi e konfiskime të pasurisë ndaj personave që zhvillojnë veprimtari armiqësore.

Deklasifikuar me vendimin Nr. 1 Datë 29.3.2013

Afati i ruajtjes i përhershëm

Sasia e fletëve 93

Ka filluar më 15.04.1954

Ka mbaruar më 16.12.1954

Regjistruar në inventarin e dosjeve me numur rendor

AIDSSH

Vendime të Komisionit të Internim-Dëbimeve për masa internimi, lirime nga internimi, konfiskim të pasurisë ndaj personave që zhvillojnë veprimtari armiqësore.

MEDIA FAQE #2



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE
MINISTRIJA E PUNEVE TE BRENDESHME
KOMISJONI DEBIMEVE E KONFISKIMEVE
Nr. 151 Res.

TEPER SEKRET.

Tirane me 3 korrik 1954.

V E N D I M. Nr. 5

Komisjoni Debimeve e Interrnimeve pran Ministrise se Puneve te Brendeshme, ne mbledhjen e tij qe pati me daten 2 Korrik 1954, i Kryesuar nga Zv.Kryetari Komisjonit Gjeneral-Major Kadri Hazbiu, duke qene prezent dhe arntaret e Komisjonit Gjeneral-Major Mihallaq Ziçishti, N/Kolonel Nevzat Haznedari, N/Kolonel Rexhep Kolli, N/Kolonel Jashar Kasimati, ne munges te Kryetarit Komisjonit Gjeneral-Leitnant Mehmet Shehut dhe antarit Komisjonit Gjeneral-Major Delo Babilit.

Mbasi mori ne shqyrtim propozimet e Drejtorive te Puneve te Brendeshme per interrnimin e disa personave dhe familjeve qe paraqesin rrezikshmeni dhe nuk mbajne qendrim te mire politik;

V E N D O S I:

1. [redacted], nga Katundi Ajnikoll e rrethit Gjinokaster, e dl. 1894, e prekur nga Reformat e Pushtetit Popullore, ka nji djale te arratisur i cili vjen si diversant. Te shperngulet familjarisht per ne rrethit e Beratit me qendrim te detyrushem.-

2. [redacted] i dl.1905, lindur dhe banus ne katundin Maqellare te Peshkupis, ky sot ndodhet ne burk per çeshtje politike dhe kohet e fundit mbaron afatin, esht i cilsuar kulak, katundi esht buze kufirit. Te interrnohet 3 vjet ne kampin Nr.2 Shtyllas Fiere, duke i filluare ____95 dhe duke i mbaruar me ______1957.

3. [redacted], nga katundi Mzi i Pukes, i biri [redacted] dhe [redacted] i dl.1930, shtres e mesme, ky ka baban dhe dy vllezer te arratisur vet nuk mban qendrim te mire. Te interrnohet 3 vjet ne kampin Nr.5 Lushnje duke i filluare me 15 Korrik 1954 dhe duke i mbaruar me 15 Korrik 1957.

4. [redacted] te dl.1897, 1935, 1937, nga katundi Pjetershan i Koplikut Qarkut Shkodres, e cila ka djalin te arratisur [redacted] i cili vjen si diversant. Te shperngulet ne Fermen e çlirimit Fiere me qendrim te detyrushem.

Vendime të Komisionit të Internim-Dëbimeve për masa internimi, lirime nga internimi, konfiskim të pasurisë ndaj personave që zhvillojnë veprimtari armiqësore.

MEDIA FAQE #3



-2-

5. [redacted] dhe [redacted], te dl.1899, 1899, 1915, 1940, 1945, kjo esht familja e diversantit [redacted] e cila paraqet rrezikshmeni arratisje per ne Jugosllavi. Te interrnohet 5 vjet ne kampin Nr. 5 Lushnje, duke i filluare me 24-Maj-1954 dhe duke i mbaruar me 24 Maj - 1959.

6. [redacted] dhe [redacted], te dl.1910, 1936, 1937, 1935, 1941, 1943, 1944 e 1945, nga Shkodra. Kjo esht familja e te arratisurit([redacted]) [redacted] i cili vjen si diversante. Te interrnohen 5 vjet ne kampin Nr.5 Lushnje, duke i filluare me 24 Maj 1954 dhe duke i mbaruar me 24 Maj 1959.

7. [redacted] nga katundi Arre e Shllakut, vjeç 34, shtres e varfer. Ky ka nji vlla te arratisur [redacted]. [redacted] esht baze e diversantit [redacted] me shoke e bandes tije. Te interrnohet 5 vjet ne kampin Nr.5 Lushnje, duke i filluare me 24 Maj 1954 dhe duke i mbaruar me 24.V.1959.

8. [redacted], i dl.1914, lindur dhe banus ne katundin Vukjakaj te Lokalitetit Shllakut te Qarkut Shkoder, me Kombesi dhe nenshtetesi shqipetare, pa Parti. Ky esht strehus i [redacted] dhe vet paraqet tendence arratisje. Te interrnohet 5 vjet ne kampin Nr.5 Lushnje, duke i filluare me 24 Maj 1954 dhe duke i mbaruar me 24 Maj 1959.

9. [redacted], i biri [redacted] dhe i [redacted], i dl.1920, lindur dhe banus ne katundin Debrove te Rrethit Pogradec, bujk, shtres e pasur(agallare) ky ka nji vlla te arratisur i cili vjen si diversant ([redacted]. Kohet e fundit [redacted] ka tendenca arratisje. Te interrnohet 5 vjet ne kampin Nr. 5 Lushnje, duke i filluare me 24 Maj 1954 dhe duke i mbaruar me 24.V.1959.

10. [redacted], i biri [redacted] dhe i [redacted], lindur dhe banus ne katundin Trebinje te Pogradecit, i dl.1926, bujk, me arsim 4 fillore, esht i prekur nga Reforma Agrare, i cilsuar Kulak. Ka nji vlla te arratisur i cili vjen si diversant([redacted]). [redacted] kohet e fundit ka tendenca arratisje. Te interrnohet 5 vjet ne kampin Nr.5 Lushnje, duke i filuare me 15 Korrik 1954 dhe duke i mbaruar me 15 Korrik 1959.

11. [redacted], i biri [redacted] dhe i [redacted], lindur me 1897 ne Diber te Madhe Jugosllavi dhe banus ne Tirane, ish Oficer Madhor ne rregjimin e kaluar, sot pa pune; vetem se merret me perkthime ne shtepi. Te interrnohet 5 vjet ne kampin Nr.2 Shtyllas Fire. Duke i filluare me 11.6.1954 dhe duke i mbaruar me 11.6.1959.

Vendime të Komisionit të Internim-Dëbimeve për masa internimi, lirime nga internimi, konfiskim të pasurisë ndaj personave që zhvillojnë veprimtari armiqësore.

MEDIA FAQE #4



-3-

(67)

12.Fe[redacted]i,i biri I[redacted],lindur me 1903,ne Prenjes,Lokaliteti Gjerbes te rrethit Skrapar,shtres e mesme fshatare.Ky ka qene Prefekt ne kohen e Okupacionit dhe me vone Federal i Fashizmit,sot nuk mban qendrim te mire.Te internohet 5 vjet ne kampin Nr.2 Shtyllas-Fier.Duke i filluare me daten ______ 1954 dhe duke i mbaruar me ______ 1959.

13.Q[redacted]i dL.1918,lindur ne Kuç te rrethit Rroskovec dhe banus ne Remanic te Beratit.Ky ka qne i arratisur ne Jugosllavi dhe i derguar nga U.D.Bzeja Jugosllave si diversant ne Shqiperi,ketu u zu dhe u denuar,kohet e fundit mbaron afatin e denimit.Te interrnohet 5 vjet ne kampin Nr.2 Shtyllas-Fier.Duke i filluare me ______ 1954 dhe duke i mbaruar me ______ 1959.

14.Dh[redacted],i biri [redacted] dhe i [redacted]i dl.1932,lindur dhe banus ne katundin Gline,me nenshtetesi dhe Kombesi MinoritareeGreke, beqar,shtres e mesme.Te shperngulet me gjith temen ne Fermen e Çlirimit Fiere me qendrim te detyrushem.

15.Ga[redacted],nga katundi Starove i rrethit Pogradecit,ish N/Toger dhe per qendrim te keq Politik esht çmobilizuar e ka shkuar ne katundin e tij Starove.Ketu nuk mban qendrim te mire,ka tendence arratisje. Te shperngulet me gjith grua ne fermen e Çlirimit Fiere me qendrim te detyrushem.

16.Ja[redacted],i biri N[redacted]dhe i Va[redacted]lindur me 1911 ne qytetin e Fierit dhe banus ne Ndermarrjen Elektorale,here ne Vlore dhe here ne Korçe.Me profesjon Dr.Veterinjer,me arsim te lart(mbaruar gjymnazin ne Shkoder)me vone ne Itali per Dr.Veterinjes,shtres e pasur,Ky esht me qendrim te keq politik.Te interrnohet 5 vjet ne kampin Nr.2 Shtyllas Fiere,duke i filluare me 15 Korrik 1954 dhe duke i mbaruar me 15 Korrik 1959.

17.Jor[redacted] me gjith familjen e tij,te cilet jane shperngulur nga katundi Sotire i Dropullit Gjinokastres per ne Culas te rrethit Lushnjes.Te lirohet dhe te lejohet te banoi familjarisht ne Tirane prane pjeses familjes qe ka ne Tirane.

18.Ra[redacted]i biri N[redacted] dhe i D[redacted],i dl.1927,nga Homçani Pogradecit,bujk,me tre klas shkoll fillore,i martuar,i pa organizuare,per qendrim te keq politik.Te shperngulet familjarisht ne fermen e Çlirimit Fiere me qendrim te detyrushem.

Vendime të Komisionit të Internim-Dëbimeve për masa internimi, lirime nga internimi, konfiskim të pasurisë ndaj personave që zhvillojnë veprimtari armiqësore.

MEDIA FAQE #5



-4-

(68)

19.Y[redacted]a,i dl.1928,me arsim 4 klas fillore,me profesjon N/Punes,shtres e mesme qytetare.Ka qene pergjegjes i Rinis Ballit dhe me çlirimin e shqiperise esht denuar me 101,zbritur ne 10 vjet,po te lirohet paraqet rrezikshemni qenja e tij i lire.Te interrnohet 5 vjet ne Kampin Nr.2 Shtyllas-Fiere,duke i filluare me 12.9.1954 dhe duke i mbaruare me 12.9.1959.

20.Ha[redacted](Emigrant Jugosllave me Nenshtetesi shqipetare)i cili ndodhet ne Llakatund te Qarkut Vlore.Te lirohet me nji here qe te shkoi e te banoi ne katundin Spitalle te Qarkut Durres.

21.H[redacted] dhe D[redacted],te dl.1934,1930,nga katundi Bugjinac e Qarkut Diber,te cilet jane e shoqa dhe i vllai i te arratisurit Myrteza.Te interrnohen 3 vjet ne kampin Nr.5 Lushnje,duke i filluare me 15 Korrik 1954 dhe duke i mbaruar me 15 Korrik 1957.Ndersa pjesa tjeter e kesaj familje te mbetet e lire.

22.Re[redacted],i biri D[redacted] dhe i M[redacted],lindur dhe banus ne katundin Kocul te rrethit Kotes,i dl.1908,me arsim te lart Ekonomik e Politik,Universitetin e ka kryer ne Itali,me profesjon pronar,me gjendje ekonomike te mire.Sot nuk mban qendrim te mire politik.Te interrnohet 5 vjet ne kampin Nr.2 Shtyllas Fiere,duke i filluare me 15 Korrik 1954 dhe duke i mbaruar me 15 Korrik 1959.-

Ky vendim hyne me nji here ne fuqi.-

ZV.KRYETAR'I KOMISJONIT
GJENERAL-MAJOR
(Kadri Hazbiu)

| ANETAR | ANETAR | ANETAR | ANETAR |
|---|---|---|---|
| N/KOLONEL | N/KOLONEL | N/KOLONEL | GJENERAL-MAJOR |
| (Jashar Kasimati.) | (Rexhep Kolli.) | (Nevzat Haznedari.) | (Mihallaq Ziçishti) |

Vendime të Komisionit të Internim-Dëbimeve për masa internimi, lirime nga internimi, konfiskim të pasurisë ndaj personave që zhvillojnë veprimtari armiqësore.

INFORMACION

# Vendime të Komisionit të Internim-Dëbimeve për masa internimi, lirime nga internimi, konfiskim të pasurisë ndaj personave që zhvillojnë veprimtari armiqësore.

| | |
|---|---|
| FONDI | 49 |
| DEGA | V |
| DOSJA | 16 |
| VITI | 1954 |
| | 93 |
| VENDIM | |
| APROVUAR NGA | Kadri Hazbiu |
| ANËTARËT | Rexhep Kolli, Nevzat Haznedari dhe Mihallaq Ziçishti |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

# Vendimi i internimit të 34 personave në Lushnjë, 1958

MEDIA FAQE #1



Mod- 7

Emërtimi i institucionit Drejtoria e Sig. të Shtetit
Emërtimi i sektorit Dega V Hetuesia

DOSJE Nr. 32 Viti 1958

TITULLI I DOSJES

Vendime të Komisionit të Internim Dëbimeve mbi internimet dhe lirimet nga internimi dhënë personave që zhvillojnë veprimtari armiqësore.

Deklasifikuar me vendimin Nr. 1 Date 29 3 2013

Afati i ruajtjes i përhershëm
Sasia e fletëve 53

Ka filluar me 14.01.1958
Ka mbaruar më 11.12.1958
Regjistruar në inventarin e dosjeve me numur rendor ______

AIDSSH

Vendimi i internimit të 34 personave në Lushnjë, 1958

MEDIA FAQE #2



U (28)

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
MINISTRIJA E PUNVE TË MBRËNDËSHME
"KOMISJONI INTERNIM-DËBIMEVE"

"TEPËR SEKRET"
Ekzemplar Nr. -____
Tiranë,më 13/8/1958

V E N D I M Nr. 16

Komisjoni i Internim-dëbimeve,pranë Ministrisë Punve të Mbrëndëshme,në mbledhjen e tij datë 13/VIII/1958,i kryesuar nga Zv.Ministër i Punve të Mbrëndëshme Gjeneral-Major Mihallaq Ziçishti dhe i përbërë nga Kolonel Rexhep Kolli,Kolonel Nevzat Haznedari dhe Kolonel Ndreko Rino,i udhëhequr nga neni 21 i Kodit Penal të Republikës Popullore të Shqipërisë si dhe të dekretit Presidiumit Kuvëndit Popullor Nr.1906 datë 2 Gusht 1954,mbasi studjoi materjalet dhe propozimet e paraqitura nga organet mvartëse:

V E N D O S I

T'internohen për 5 vjet kohë personat e posht shënuar, të cilët paraqesin rrezikshmëni shoqërore;duke u filluar më 13/8/1958 dhe u mbaron më 13/8/1963, të përmëndurit internohen në rrethin e Lushnjës.

1)[redacted] i dat-lindjes 1921,lindur në Dibër të Madhe Jugosllav

2)[redacted] e dat-lindjes 1925,lindur në Dibër të madhe dhe banuse në qytetin e Tiranës, gruaja e [redacted]

3)[redacted],i dat-lindjes 1915,lindur në Rekë Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

4)[redacted] e dat-lindjes 1925,lindur në Rekë Jugosllavi dhe banuse në qytetin e Tiranës,gruaja e [redacted]

5)[redacted] i dat-lindjes 1928,lindur në Shkup Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

6)[redacted] e dat-lindjes 1926,lindur në Shkup Jugosllavi dhe banuse në qytetin e Tiranës,gruaja e [redacted].

7)[redacted] dat-lindjes 1921,lindur në Gjakovp Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës;

8)[redacted]),e dat-lindjes 1930,lindur në Gjakovë dhe banuse në qytetin e Tiranës;gruaja e [redacted]

9)[redacted] dat-lindjes 1930,lindur në Gjakovë dhe banusë në qytetin e Tiranës.

%%%

AIDSSH

Vendimi i internimit të 34 personave në Lushnjë, 1958

MEDIA FAQE #3



- 2 -

10)[redacted],i dat-lindjes 1931,lindur në Dibër të Madhe dhe banusë në qytetin e Tiranës.

11)[redacted] i dat-lindjes 1917,lindur në Pejë dhe banusë në qytetin e Tiranës.

12)[redacted] i dat-lindjes 1921,lindur në Pejë Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

13)[redacted],e dat-lindjes 1922,lindur në Pejë Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

14)[redacted] dat-lindjes 1926,lindur në Kërçovë Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

15)[redacted] gruaja e [redacted]

16)[redacted] i dat-lindjes 1926,lindur në Dibër të Madhe Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

17)[redacted],i dat-lindjes 1924,lindur në Rekë Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

18)[redacted],e dat-lindjes 1927,gruaja e [redacted]

19)[redacted],i dat-lindjes 1934,lindur në Dibër të Madhe Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

20)[redacted] dat-lindjes 1914,lindur në Tetovë Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

21)[redacted],i dat-lindjes 1921,lindur në Rekë Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

22)[redacted],e dat-lindjes 1929,gruaja e [redacted]

23)[redacted],i dat-lindjes 1913,lindur në Dibër të Madhe Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

24)[redacted],e dat-lindjes 1927,gruaja e [redacted]

25)[redacted] i dat-lindjes 1926,lindur në Strugë Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

26)[redacted],i dat-lindjes 1914,lindur në Gostivar Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Turanës.

27)[redacted] e dat-lindjes 1930,gruaja e [redacted]

28)[redacted] i dat-lindjes 1903,lindur në Prishtin Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

%%

ADSSH

Vendimi i internimit të 34 personave në Lushnjë, 1958

MEDIA FAQE #4



- 3 -

29)[redacted],i dat-lindjes 1925,lindur në Tetovë Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

30)[redacted](Ganiu),gruaja e [redacted]

31)[redacted],i dat-lindjes 1930,lindur në Grudë Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës

32)[redacted],i dat-lindjes 1922,lindur në Pejë Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

33)[redacted] e dat-lindjes 1923,gruaja e [redacted].

34)[redacted],i dat-lindjes 1931,lindur në Tetovë Jugosllavi dhe banusë në qytetin e Tiranës.

35)[redacted],i biri [redacted] dhe i [redacted] i dat-lindjes 1911, lindur dhe banusë në qytetin e Tiranës. Internohet në Fier për rrezikshmëni shoqërore,duke i filluar më 29/7/1958 dhe i mbaron më 29/7/1963 për 5 vjet kohë.

36)[redacted] i biri [redacted] dhe i [redacted],i dat-lindjes 1939,lindur në katundin Dushar të Korçës dhe banusë në qytetin e Tiranës,i cili internohet në Fier për 5 vjet kohë,duke i filluar më 29/7/1958 dhe i mbaron më 29/7/1963,për rrezikshmëni shoqërore.

37)[redacted] dat-lindjes 1917,lindur dhe banusë në katundin Arez të rrethit Korçës,i cili internohet në Fier për 5 vjet kohë duke i filluar më 13/8/1958 dhe i mbaron më 13/8/1963,për arsye se më 3/8/1958 i është aratisur djali i tij [redacted].

ZV.KRYETAR'I KOMISJONIT INTERNIM-DËBIMEVE
GJENERAL-MAJOR
(Mihallaq Ziçishti)

| | | |
|---|---|---|
| A N T A R | A N T A R | A N T A R |
| K O L O N E L | K O L O N E L | K O L O N E L |
| (Rexhep Kolli) | (Nevzat Haznedari) | (Nreko Rino) |

ADSSH

Vendimi i internimit të 34 personave në Lushnjë, 1958

INFORMACION

## Vendimi i internimit të 34 personave në Lushnjë, 1958

| | |
|---|---|
| FONDI | 49 |
| DOSJA | 32 |
| | 60 |
| VITI | 1958 |
| VENDIM | Nr. 6 dt. 13.08.1958 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

# endimi për internimin e një familjeje në Çermë, Lushnjë – 1975

MEDIA FAQE #1


Mod. 7

Emërtimi i institucionit Ministria e Punëve të Brendshme

Emërtimi i sektorit Drejtoria e Sig. të Shtetit

Dega 8

DOSJE Nr. 127 Viti 1975

TITULLI I DOSJES

Vendime të Komisionit të Internim-Dëbimit rreth internimin e dëbimin e ~~personave me qëndrim të keq politik e shoqëror~~

Deklasifikuar me vendimin Nr. 1 Datë 21.7.2017

Afati i ruajtjes i përhershëm

Sasia e fletëve 84

Ka filluar më 08.02.1975

Ka mbaruar më 31.12.1975

Regjistruar në inventarin e dosjeve me numur rendor ________

AIDSSH

endimi për internimin e një familjeje në Çermë, Lushnjë – 1975

MEDIA FAQE #2


11

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERIS
KOMISIONI I INTERNIM - DEBIME'E

" S e k r e t "
Ekzemp. Nr___
Grupi II-III

Tiranë, më 29.4.1975.

V E N D I M Nr. 3

Komisioni i Internim-Debimeve i mbledhur më datën 29.4.1975 në bazë të dekretit të Presidjumit të Kuvendit Popullor Nr. 1906 datë 2.8.1954, mbasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Minstria e P. Brendshme

V E N D O S I

Per arsye se janë me prejardhje të keqe politike dhe aktualisht nuk mbajnë qendrim të mirë, një pjestar i familjes së tyre zhvillon veprimtari armiqsore në formën e agjitacion propagandës, të internoj per 5 vjet kohë në sektorine e Çermës të N.B " 29 Nendorit " të rrethit Lushnjë, personat e posht shenuar :

1. [redacted], i dl. 1919, lindur në Libohovë të Gjirokastrës dhe me banim në Tiranë, i martuar me tre femij, me arsim të mesmë, me origjinë shtres nenpunsish, aktualisht puntor.

2. [redacted] e dl. 1883; lindur në Gjirokastër dhe banuse në Tiranë, shtepiake ( [redacted] )

3. [redacted], e dl. 1923, lindur në Ersek dhe me banim në Tiranë, e martuar me tre femij, puntore, me origjinë fshatare e pasur ( e bija e [redacted] dhe e shoqja e [redacted].

4. [redacted] e dl. 1953, lindur dhe banuse në Tiranë, me arsim të mesmë, aktualisht pa punë, ( e bija e [redacted] ).

5. [redacted] e dl. 1957, lindur dhe banuse në Tiranë nxenëse në vitin e fundit gjimnas ( e bija e Hajdarit ).

Afati i internimit u fillon më datën 29.4.1975 dhe u mbaron më datën 29.4.1980.

Zv. Kryetari i Komisonit
/ Kadri Hazbiu /

Kryetari i Komisionit
/ Xhafer Spahiu /

AIDSSH

MEDIA FAQE #3


- 2 -

A n t a r ë t

Prekurori i Përgjithshmë
/ Dhori Panarit /

Kryetari i Gjykatës Lartë
/ Aranit Çela /

endimi për internimin e një familjeje në Çermë, Lushnjë – 1975

INFORMACION

## endimi për internimin e një familjeje në Çermë, Lushnjë – 1975

| | |
|---|---|
| FONDI | 4 |
| DOSJA | 127 |
| DEGA | V |
| VITI | 1975 |
| NUMRI I FAQEVE | 84 |
| VENDIM | nr. 3 |
| DATË | 29.04.1975 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

# Vendim nr 7 i dt. 30.01.1954 per konfiskim pasurie

MEDIA FAQE #1



Mod. 7

Emërtimi i institucionit Drejtoria I-rë, Sig. i Shtetit
Emërtimi i sektorit Hetuesia

DOSJE Nr. 15 Viti 1954

TITULLI I DOSJES

Vendime të Komisionit të Internim-Dëbimere për masa internimi, lirime nga internimi dhe konfiskime për persona që zhvillojnë veprimtari armiqësore.

Deklasifikuar me vendimin Nr 1 Date 29.3.2013

Afati i ruajtjes i përhershëm
Sasia e fletëve 37

Ka filluar më 30.01.1954
Ka mbaruar më 31.03.1954
Regjistruar në inventarin e dosjeve me numur rendor

ADSH

Vendim nr 7 i dt. 30.01.1954 per konfiskim pasurie

MEDIA FAQE #2



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE
MINISTRIJA E PUNEVE TE BRENDESHME
KOMISJONI DEBIMEVE E KONFISKIMEVE
Nr. 7 Vendimit.

TEPER SEKRET.
Tirane me 30-I- 1954.

Nr. 30

VENDIM.

Komisjoni debimeve dhe konfiskimeve pran Ministrise se Puneve te Brendeshme, i perbere prej:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Gjeneral-Leitnant | Mehmet Shehu | Kryetar |
| 2. Gjeneral-Major | Mihallaq Ziçishti | Anetar |
| 3. N/Kolonel | Nevzat Haznedari | Anetar |
| 4. N/Kolonel | Rexhep Kolli | Anetar |
| 5. N/Kolonel | Jashar Kasimati | Anetar |
| 6. Major | Sabri Sevrani | Anetar |

Ne seancen e dates 8 Janar 1954, mbasi mori ne shqyrtim propozimin e Drejtoris Puneve te Brendeshme te Qarkut Shkoder per konfiskimin e pjeses pasuris t'arratisurve ne Jugosllavi, [redacted] nga katundi Kastrati i Shkodres dhe [redacted] nga katundi Shirok i Lokalitetit Qendres Shkoder;

KONSTATOIN-SE:

Duke qene se [redacted] nga Kastrati dhe [redacted] nga Shiraka ndodhen te arratisur te dy ne Jugosllavi dhe pasurija e tyre ndodhet e bllokuare nga ana e gjykates Popullore, ne mbeshtetje te nenit 1 te ligjit Nr.649 date 10 Janar 1949 mbi zbatimin e debimeve dhe konfiskimeve

VENDOSI:

Konfiskimin e pjeses pasuris te arratisurit [redacted] dhe [redacted], ndersa pasurija qe i perket familjes te lihet e lire.

KRYETAR'I KOMISJONIT
GJENERAL-LEITNANT
(MEHMET SHEHU)

| ANETAR | ANETAR | ANETAR | ANETAR | ANETAR |
|---|---|---|---|---|
| MAJOR | N/KOLONEL | N/KOLONEL | N/KOLONEL | GJENERAL-MAJOR |
| (SABRI SEVRANI) | (JASHAR KASIMATI) | (REXHEP KOLLI) | (N.HAZNEDARI) | (MIHALLAQ ZICISHTI) |

ADSH

Vendim nr 7 i dt. 30.01.1954 per konfiskim pasurie

INFORMACION

# Vendim nr 7 i dt. 30.01.1954 per konfiskim pasurie

Autoret: Komisioni i Konfiskim _Dëbimeve

| | |
|---|---|
| DOSJA | 15 |
| VITI | 1954 |
| NUMRI I FAQEVE | 50 |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Vendim i Komisionit të Internim - Dëbimeve |
| VENDIM | nr. 7 |
| DATË | 30.01.1954 |
| KOMISIONI | Mehmet Shehu |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.